



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Gjilanit
Opština Gnjilane
Municipal Gjilan
Gilan Belediyesi

Në bazë nenit 11 parag.1 dhe nenit 12 parag.1 nënparagr.1.1 të Ligjit mbi Shërbimin Civilë të Republikës së Kosovës, Nr.03/L-149 dhe neni 20 parag.2 lidhur me neni 15 parag. 1 të Rregullorës për Procedurat e Rekrutimit , Kryetari i Komunës në koordinim me Njësine për Personel shpall :

K o n k u r s

Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim

Sektori/Njësia-Shërbimi i Zjarrfikësve

Funksioni / Titulli i pozitës : Zjarrëfikës dy (2) egzekutues

Numri i referencës : 03/2011

Grada / Koeficienti:5.5

Lloji i emërimit : **I KARRIERËS**

Kohëzgjatja : **zbatohet periudha provuese prej dymbëdhjetë (12) muaj me mundësi të vazhdimit të aktit të emërimit**

Orari i plotë : 40 orë në javë

Detyrat dhe përgjegjësit :

- Drejtërsëdrejti merr pjesë në shuarjen e zjarrit,shpëtimin e jetës së njerëzve dhe pasurisë si dhe në fatkeqësit tjera elementare,
 - Kryen shërbimin e kujdestarisë në ndërrimin e vetë dhe pranon lajmërimin e zjarreve dhe fatkeqësive tjera,
 - Punon me ndërrime në gjendje gatishmërie në orar të punës dhe jashtë orarit sipas nevojës,
 - Merr pjesë në rregullimin e mjeteve dhe pajisjeve zjarrëfikëse si dhe zbaton masat preventive të mbrojtjes nga zjarri,
 - Merr pjesë në gara të zjarrëfikësve dhe shpëtimit si dhe ushtrimet publike,
 - Në raste zjarri dhe fatkeqësive elementare punon me pompë motorike duke u kujdesur edhe për paisjet personale e të përbashkëta,
 - Kujdeset për mirëmbajtjen e stacionit të zjarrëfikësve,
 - Merr pjesë në trajnime dhe ligjerata me interes për SHZSH,
 - Në orar të punës nuk guxon të merret me punë tjera dhe është i obliguar që oficerët me gradë më të lartë të i përshëndes,
- Gjatë kujdestaris kontrollon çdo hyrje e dalje në lokalet e SHZSH dhe ndalon hyrjen e të pa nëve në to,
- Punon me ndërrime dhe gjatë orarit të punës në stacion bartë uniformën e punës.

Kushtet për punësim :

- Të ketë përgatitjen e mesme profesionale,të mos jetë më i vjetër se 35 vjet të ketë aftësi psiko fizike dhe aftësi për kryerjen e punëve në këtë shërbim çka dëshmohet me çertifikatë valide mjekësore konform të gjitha këto konform nenit 32 të Ligji Nr. 02/L-41 për Mbrojtjen nga Zjarri.
- Të ketë përvoj pune 1 vit si zjarrëfikës,

- Certifikata mbi trajnimet profesionale të zjarrëfikjes dhe shpëtimit

Çdo kandidat (aplikues) për pozitën e lartcekur duhet t'i kompletoj dhe dorëzoj dokumentacionin e domosdoshëm (kopje) si vijon :

1. Dëshmi të kualifikimit shkollorë,
2. Dëshmi mbi përvojën e punës,
3. Letër rekomandmet,
4. Dokumentin e identifikimit
- 5.

Certifikatën mjekësore për punësim ,

Aplikacionet merren dhe të plotësuara dorëzohen në arkivin qendror të Komunës së Gjilanit, përkatësisht në Qendrën për Shërbim të Qytetarëve

Afati i aplikimit është 15 ditë, nga dita e shpalljes publike në gazet dhe në mjetet e tjera të informimit.

Aplikacionet e dorëzuara pas afitit të paraparë nuk pranohen dhe aplikacionet e mangëta refuzohen.

Vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e shkurtër do të kontaktohen për testim dhe intervistë. Shërbimi Civilë i Kosovës, ofronë mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Republikës së Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinsë mashkullore dhe femrore nga të gjitha komunitetet në Kosovë.